



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA KOLONJË  
KRYETARI

Nr. 5169 Prot

Ersekë më, 27.10.2021.

**NJOFTIM**

**PËR SHPALLJE TË KONKURIMIT PËR DREJTUES NË ARSIMIN PARASHKOLLOR**

Kopshti Nr.1 "AFERDITA KOLE", Nr.2 "MARIE GJERGO" Ersekë, në zbatim të Ligjit Nr.69/2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, Neni 55, 57 pika 1/a. Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020 "Për procedurat e emërimit, pezullimit dhe shkarkimit të drejtorit të institucionit publik të arsimit parauniversitar, shpall njoftimin e kërkesave për vend të lirë pune për 2 (dy) vende në pozicionin **Drejtor Kopshti** në:

1. Kopshti Nr.1 "Afërdita Kole" Ersekë .

2. Kopshti Nr.2 "Marie Gjergo" Ersekë .

Të gjitha mësueset (edukatore) të njëjtit profil (parashkollor) të kopshteve të qytetit Ersekë dhe të Njësi Administrative të interesuara për këto pozicione pune, duhet të paraqesin pranë Drejtorisë së ZHEF-së në Bashki cdo ditë nga ora 08.00 deri në 14.00 dokumentacionin e mëposhtëm.

- Diplomë e nivelit të parë të studimeve universitare, sipas përcaktimeve të nenit 57 të Ligjit 69/2012, date 21.06.2012 "Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar (fotokopje e noterizuar e diplomës dhe listës së notave të shkollës së lartë).
- Të ketë të paktën kategorinë "Mësues I Kualifikuar".
- CV dhe kopje të dëshmimeve apo dokumente që vërtetojnë pohimet në CV (sipas Shtojcës Nr.4 të Udhëzimit Nr. 2 datë 28.01.2020).
- Raport mjeko-ligjor.
- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi .
- Dëshminë e penalitetit, të lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj para datës së aplikimit.
- Si dhe të gjithë dokumentacionin e paraqitur në Pikën B/ 2 sipas Udhëzimit Nr.2 datë 28.01.2020 me Shtojcat përkatëse.

Afati I fundit për dorëzimin e dokumentave do jetë data 08.11.2021 .

KRYETARI

ERION JSAI

